



FTESË PËR OFERTË

Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) është institucion mikrofinanciar i cili me qëllim të zgjedhjes së kompanisë për mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve për vitin 2025, fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin ofertat e tyre për:

SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E E AUTOMJETEVE

Kreditimi Rural i Kosovës ka gjithsej **83 vetura**, prej tyre 53 vetura të markës Volkswagen (Golf dhe Polo), 1 veturë të markës Opel, 6 vetura Seat Ibiza, 4 Skoda Octavia 2017-2019, 7 Toyota Auris dhe 11 Toyota Yaris

Veturat janë të bazuara në komunat e Kosovës siq vijon: Deçan, Ferizaj, Gjakova, Gjilan, Gllogoc, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malisheva, Mitrovicë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suhareka, Viti, Vushtrri, Dragash, Kamenice, Fushe Kosove, Obiliq dhe Gracanice.

Numri i veturave mund të ndryshoj gjatë vitit.

Ofertat për servisim dhe mirëmbajtje të automjeteve do të vlerësohen sipas kushteve dhe kriterëve të poshtëshënuara:

1. Çmimi më i volitshëm i pjesëve rezerve dhe shërbimeve (çmimet duhet të jenë për njësi dhe në çmim të përfshihet TVSH),
2. Prejardhja e pjesëve rezerve,
3. Eksperiencës së ofertuesit në punët e servisimit dhe mirëmbajtjes,
4. Garancioni për pjesët rezerve dhe shërbimet e ofruara,
5. Posedimi i aparaturës kompjuterike për diagnostifikim të defekteve të automjeteve.
6. Posedimi i serviseve në komunat apo afërsi të komunave ku janë të bazuara veturat e KRK-se.

Ofertuesit duhet të paraqesin listën e çmimeve të shërbimeve të zakonshme për servisim të rregullt, mirëmbajtje duke përfshirë punën dhe pjesët rezerve.

Kontrata me ofertuesin e sukseseshëm do të lidhet me afat një vjeçare me mundësi ripërtëritje.

Afati për paraqitjen e ofertave është deri me datën **26.11.2024** në adresën e më poshtme: Kreditimi Rural i Kosovës LLC / Rr. Behije Dashi, Objekti D / 10000 Prishtinë apo përmes email adresës krk_imf@krk-ks.com.